



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK



Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

DORACAKU I PROCEDURAVE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E OIK-UT

HAPJA E VENDVOTIMIT - VOTIMI

1. Në ora 07:00 shpall vendvotimin zyrtarisht të hapur për votim.
2. Anëtarët e KNJZ-së votojnë të parët.
3. Anëtarët e KNJZ-së duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës në vendvotim.
4. Në rast të daljes nga vendvotimi të një anëtari kryetari i KNJZ-së shënon arsyen e mungesës në Librin e Vërejtjeve.

PROCEDURA E VOTIMIT

5. Votuesi tregon dokumentin identifikues para anëtarit të KNJZ-së.
6. Pasi identifikimit nga KNJZ, votuesi nënshkruhet në listën votuese.
7. KNJZ- jep fletëvotimin e shkëputur nga dengju i fletëvotimeve dhe e njofton se ka të drejtë vote vetëm për një kandidatë.
8. Votuesi shkon në kabinën e votimit për të votuar fshehtas .
9. Pasi të ketë vendosur fletëvotimin në kutinë e votimit, votuesi duhet të dalë nga qendra e votimit

MBYLLJA E VENDVOTIMIT

10. Në ora 19:00 Kryetari i KNJZ-së, pasi të jetë siguruar se asnjë votues nuk është në radhë duke pritur për votim, e mbyll vendvotimin.
11. Pas mbylljes së vendvotimit asnjë person i paautorizuar nuk mund të hyjë në qendër votuese përveç anëtarëve të KQZ, Sekretariatit të KQZ-së dhe vëzhguesve.

DETYRAT E KNJZ-SË PARA HAPJES SË KUTISË SË VOTIMIT

12. Mbyllet vrima e mesit të kutisë me shirit.
13. Numërohen nënshkrimet e votuesve në Listën e Votuesve dhe shuma e nënshkrimeve shkruhet në procesverbalin e mbylljes së votimit
14. Numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe shuma e tyre shënohen në procesverbalin e mbylljes së votimit
15. Fletëvotimet e papërdorura futen në zarfe të bardhë të cilat duhet të jenë jashtë kutisë së votimit.
16. Numri i shiritave anësorë shënohet në procesverbalin e mbylljes së votimit.

PROCEDURA E NUMËRIMIT TË VOTAVE

17. Kryesuesi i KNZ-së hap kutitë e votimit duke prerë shiritat anësor të kutisë së votave.
18. Fletëvotimet brenda në kuti vendosen në tavolinën e numërimit
19. Klasifikohen fletëvotimet në të vlefshme dhe të pavlefshme.
20. Fletëvotimet e pavlefshme numërohen dhe shënohen në procesverbal.
21. Fletëvotimet e pavlefshme futen në zarf të bardhë i cili vendoset brenda në kuti .
22. Fletëvotim i pavlefshëm konsiderohet fletëvotimi në të cilin është votuar më shumë se një kandidatë, fletëvotimet e paplotësuara dhe fletëvotimet në të cilat nuk mund të përcaktohet saktë për kënd është votuar.
23. Fletëvotimet e vlefshme numërohen dhe shënohen në rubrikën përkatëse në procesverbal.
24. Kryesuesi i KNJZ-së lexon votat për kandidatë, ndërsa dy anëtarët e tjerë në të njëjtën kohë regjistrojnë votat e kandidatëve në fletë të bardhë .
25. Në rast se ka mospërputhje mes votave të regjistruara nga dy anëtarët e KNJZ-së, votat do të verifikohen edhe njëherë.
26. Kryesuesi i KNJZ-së mbledh votat për secilin kandidatë dhe shumën totale e shkruan në procesverbalin e mbylljes së votimit
27. Votat e dëmtuara futen në zarf i cili mbetet jashtë kutisë së votimit.

MBYLLJA E KUTISË SË VOTIMIT

28. Votat e numëruara futen në kuti të votimit
29. Zarfi i fletëvotimeve të pavlefshme futet brenda në kuti të votimit.
30. Zarfi i fletëvotimeve të dëmtuara mbetet jashtë kutisë së votimit.
31. Kryetari i KNJZ-së mbyll me shirita kutinë e votimit, dhe numrat e shiritave mbyllës i shënon në procesverbal të mbylljes së votimit.

PUBLIKIMI I REZULTATEVE NGA KNJZ

32. Pasi të jetë plotësuar formulari i mbylljes së votimit me numrat e votave të kandidatëve të radhitur si në fletëvotim, KNJZ plotëson procesverbalin e shpalljes së rezultateve preliminare të zgjedhjes së anëtarëve të Kuvendit të OIK-ut
33. Procesverbali i rezultateve preliminare të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të OIK-ut së bashku me procesverbalin e mbylljes së votimit duhet të publikohet në derën e vendvotimit.
34. Procesverbali i anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të OIK-ut plotësohet në bazë të kriterit të numrit më të madh të votave.
35. Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë numër të njëjtë të votave, kriter i renditjes merret radha alfabetike e emrit.

PROCESVERBALET E DITËS SË VOTIMIT

- 36.** Gjatë plotësimit të procesverbalit duhet të keni kujdesm gjithmonë

Numri i Fletëvotimeve të vlefshme + numri i fletëvotimeve te pavlefshme = Numrin e antarëve pjesëmarrës në votim

Numri i fletëvotimeve të dëmtuara + numri i fletëvotimeve të vlefshme + numri i fletëvotimeve te pavlefshme = Numrin e fletëve të përdorura.

Numri i fletëve të përdorura + Numri i fletëve të pa përdorura = Numri i fletëve të pranuar nga KNJZ

Numri total i votave të kandidatëve te procesverbali i votave te kandidateve = numrin e fletëvotimeve te vlefshme

ANKESAT

- 37.** Afati i ankesave për rezultatin zgjedhor bëhet 12 orë nga shpallja e rezultatit Zgjedhor në Njësinë Zgjedhore